REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

# MANUAL

# I

# KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

# ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

# TË DATËS 23 QERSHOR 2013

TABELA E PËRMBAJTJES


I SISTEMI I ZGJEDHJEVE .......... 3

II ORGANIZIMI, FUNKSIONET, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KZAZ-SË .......... 5

III EMËRIMI I KQV-ve .......... 12

IV VERIFIKIMI I AMBJENTEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT TË NGRITURA NË KZAZ .......... 14

V LISTA PËRFUNDIMTARE E ZGJEDHËSVE .......... 15

VI PËRGATITJA DHE ORGANIZIMI I VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE .......... 17

VII GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE .......... 19

VIII DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KQZ-ja TEK KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të 20

IX VEPRIMET E KZAZ-së GJATË DITËS SË VOTIMIT .......... 25

X PAS ZGJEDHJEVE - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KQZ .......... 27

XI SHEMBUJ PRAKTIKË TË VEPRIMEVE TË NDRYSHME TË KZAZ-SË .......... 28

SHTOJCË – BAZA LIGJORE .......... 32

KODI ETIK I KOMSIONERËVE TË ZGJEDHJEVE .......... 35

**Letër përshëndetëse**

**Të nderuar anëtarë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor**

Manuali i KZAZ-së është konceptuar për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të KZAZ-ve në veprimtarinë e tyre për administrimin e procesit në zonën e administrimit zgjedhor.

Manuali përmban sistemin e zgjedhjeve, kodin e etikës, organet e zgjedhjeve, organizimi, funksioni dhe detyrat e KZAZ-së, mbledhjet, vendimmarrja, vendimet, dokumentacioni i punës së saj, përgjegjësitë dhe sanksionet për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së.
Komisionerët, gjatë trajnimit do të përdorin modelet e vendimeve dhe dokumentacionin e punës së tyre, me qëllim që të përvetësojnë sa më mirë procedurat e parashikuara në këtë Manual të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon, që gjatë punës tuaj, të gjithë aktorët në procesin zgjedhor, votuesit, kandidatët dhe partitë politike:
- t'i trajtoni në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi;
- të respektoni standardet më të larta të etikës jo vetëm me këta aktorë të rëndësishëm, por edhe me komisionerët e tjerë zgjedhorë.
- të zbatoni me përpikëmëri Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së për mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor me integritet, paanshmëri dhe transparencë, duke mbrojtur pavarësinë e funksioneve tuaja.

KQZ vlerëson angazhimin tuaj dhe beson se do t'i përmbushni plotësisht detyrimet tuaja, për të siguruar dhe garantuar zgjedhje të standarteve ndërkombëtare demokratike, të lira, të drejta, transparente dhe të pranuara nga të gjithë aktorët në këtë proces.

Duke ju uruar suksese në punën tuaj, si pjesë e kontributit qytetar për zhvillimin e zgjedhjeve , ju falenderojmë për përfshirjen tuaj në procesin zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 23 qeshor 2013.

Përgatitja dhe publikimi i manualit u realizua në bashkëpunim me Këshillin e Europës, duke nënvizuar që qendrimi i shprehur në manual nuk është qendrimi zyrtar i Këshillit të Europës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë dëshiron të falenderojë Këshillin e Europës, për mbështetjen.

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Shkurtime që përdoren në manual**

| | |
|---|---|
| **KQZ** | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| **DKZTEZ** | Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve |
| **Strategjia** | Strategjia e trajnimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore |
| **RSH** | Republika e Shqipërisë |
| **ZAZ** | Zona e Administrimit Zgjedhor |
| **ZRZ** | Zyra Rajonale Zgjedhore |
| **KZAZ** | Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor |
| **KQV** | Komisioni i Qendrës së Votimit |
| **GNV** | Grupet e Numërimit të Votave |
| **IT** | Teknologji Informacion |
| **LPM** | Libri Protokollit të Mbledhjeve |
| **SEV** | Sistemi Elektronik i Verifikimit |
| **SEN** | Sistemi Elektronik i Numërimit |
| **VNV** | Vendi i Numërimit të Votave |
| **U** | Udhëzim |
| **V** | Vendim |
| **n** | Neni |
| **nr** | Numër |
| **p** | Pika |
| **sh** | Shkronja |
| **sht** | Shtojca |
| **s** | Seksioni |
| **dt.** | Datë |
| **zv.** | Zëvendës |
| **teknologjia mbështetëse** | Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave |

## I SISTEMI I ZGJEDHJEVE

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Më 23 qershor 2013 votuesit do të zgjedhin 140 anëtarë të Kuvendit, nëpërmjet sistemit proporcional rajonal, bazuar në zona zgjedhore shumëemërore. Zona zgjedhore janë 12 dhe përputhen me 12 ndarjet administrative-territoriale të qarkut përkatës.n.74



| | | |
|---|---|---|
| Zona zgjedhore qarku Berat | 8 (tetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Dibër | 6 (gjashtë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Durrës | 13 (trembëdhjetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Elbasan | 14 (katërmbëdhjetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Fier | 16 (gjashtëmbëdhjetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Gjirokastër | 5 (pesë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Korçë | 12 (dymbëdhjetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Kukës | 4 (katër) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Lezhë | 7 (shtatë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Shkodër | 11 (njëmbëdhjetë) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Tiranë | 32 (tridhjetë e dy) | mandate |
| Zona zgjedhore qarku Vlorë | 12 (dymbëdhjetë) | mandate |

Zgjedhësit do të votojnë vetëm në një fletë votimi, duke shenjuar një listë kandidatësh apo një kandidat të pavarur. Do të përdoret vetëm një kuti votimi.





**STRUKTURA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE**



Organet e Zgjedhjeve

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)**. KQZ është organi më i lartë shtetëror, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve. KQZ përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë. Një nga detyrat e KQZ-së është emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të KZAZ-së dhe mbikqyrja e tyre në përmbushjen e detyrave.




**SKEMA E ORGANIZIMIT**

**Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ)**



KZAZ-të (89) administrojnë zgjedhjet në 89 zonat e administrimit zgjedhor. Një nga detyrat e KZAZ-së është emërimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-së. KZAZ-ja mbikqyr procesin e votimit dhe numërimit të votave.



**Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV).** KQV-të janë përgjegjëse për administrimin e procesit të votimit gjatë ditës së votimit. Në Shqipëri ka rreth 5491 KQV.

**Grupet e Numërimit të Votave (GNV).** Grupet e Numërimit të Votave përbëhen nga katër anëtarë, të cilët numërojnë votat në nivel KZAZ-je, nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV dhe plotësojnë tabelat e rezultateve për çdo qendër votimi.



## II ORGANIZIMI, FUNKSIONI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KZAZ-së

### Organizimi, funksioni dhe detyrat e KZAZ-së

KZAZ-ja i përmbush funksionet e saj në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akte të tjera normative të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Çdo KZAZ përbëhet nga 7 anëtarë dhe një sekretar të cilët emërohen në bazë të propozimeve të partive parlamentare.

**Kujdes! Zbatoni dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akteve të KQZ-zë, mosrespektimi i tyre përbën shkak për shkarkimin tuaj nga detyra!** Çdo anëtar apo sekretar i KZAZ-së mban përgjegjësi administrative për shkelje të ligjit gjatë detyrës, për të cilën mund të gjobitet deri në 500 000 Lekë, ose mund të ndiqet edhe penalisht.

KZAZ:

- ✓ Administron zgjedhjet në ZAZ;
- ✓ Emëron kryetarin, anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve;
- ✓ Emëron anëtarët e GNV-ve;
- ✓ Pret kërkesat dhe ankesat, i verifikon ato dhe merr vendimet përkatëse;

- ✓ Publikon menjëherë, vendimet e marra dhe i dërgon një kopje të tyre në KQZ;
- ✓ Afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për

caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve;
- ✓ Administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;
- ✓ Siguron shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit tek KQV-të;
- ✓ Koordinon trajnimin e KQV-ve dhe GNV-ve;
- ✓ Merr në dorëzim nga KQV-të kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha qendrat e votimit;
- ✓ Organizon VNV-të dhe mbikqyr procesin e numërimit.
- ✓ Përgatit dhe miraton Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve për ZAZ-në.

**Kujdes:** Ju mund t'i gjeni të përcaktuara detyrat e KZAZ-së në n.33, n.73, p.3, n.35, p.5, n.99, n.116 deri në n.119, n.121, p.1 dhe n.122 të KZ si dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja, n.10, p.1, n.14, p.1 e 5, n.23, p.6 të U. nr.02, dt.25.02.2009; n.3, p.2,3 dhe n.4, p.1 e U.4, dt.19.02.2013




## DETYRAT E SEKRETARIT TË KZAZ-SË

Sekretari i KZAZ-së:
- ✓ Përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës;
- ✓ Regjistron në Regjistrin e Vendimeve dhe LPM vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
- ✓ Protokollon të gjitha kërkesat, ankesat dhe njoftimet si dhe çdo dokument tjetër drejtuar KZAZ-së si dhe aktet e nxjerra prej KZAZ-së;
- ✓ Është përgjegjës dhe administron përdorimin e vulës;
- ✓ Përgatit materialet për mbledhjet, ua shpërndan ato anëtarëve dhe i njofton ata për mbledhjen;
- ✓ Mban proces-verbalet e mbledhjeve;
- ✓ U jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;
- ✓ Merr në dorëzim dhe koordinon materialet zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja;
- ✓ Lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve;
- ✓ Regjistron në LPM vërejtjet e vëzhguesve;
- ✓ Pasqyron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve:
  - mbledhjet e KZAZ-së,
  - rezultatet e votimit për çdo propozim,
  - të gjithë aktivitetin e KZAZ-së, në mënyrë të detajuar;
- ✓ Vulos çdo faqe të procesverbalit të mbajtur në LPM;
- ✓ Është përgjegjës për transmetimin e informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje gjatë ditës së votimit;
- ✓ Regjistron në Procesverbalin e Konstatimit shkeljet e konstatuara;
- ✓ Koordinon marrjen në dorëzim nga KQV-të të kutisë së votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit;
- ✓ Kryen detyra të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së.

**KUJDES!** Ju mund t'i gjeni të përcaktuara detyrat e sekretarit në n.34, n.99, n.116/1, p.2 të KZ dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja: n.13, p.2, n.17, p.2, n.20, p.3 n.24, p.3 të U.02, dt.25.02.2009, V. nr.20, dt.28.01.2013, dhe p. 3 e v.42, dt.06.12.2010

## Identifikimi i KZAZ




**Kontaktet e KZAZ-së:**

KQZ (Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve);

- Inspektorët e zyrave rajonale zgjedhore;
- Institucioni i prefekturës/nënprefekturës dhe bashkisë/komunës;
- Përfaqësuesit e partive politike, degët e partive politike në nivel lokal;
- Policia e Shtetit (trupa policore e angazhuar për zgjedhje);
- Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore;
- Median;
- Vëzhguesit e akredituar nga:
    - KZAZ
    - KQZ




**Kalendari i veprimeve të KZAZ-së**

| Veprimet | Afati |
|---|---|
| Vendos Flamurin kombëtar ( në zyrën e KZAZ-së, në një vend të dukshëm )<br>Bën publike (në hyrjen e KZAZ-së):<br>-kopjen e Dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve;<br>-emrat e anëtarëve të KZAZ-së dhe sekretarit të saj;<br>-etiketën (shënjën dalluese) për identifikimin e saj;<br>-adresën, orarin e punës 08.00–13.00 dhe 16.00- 20.00<br>-numrin e telefonit të KZAZ-së | Menjëherë pas konstituimit |
| Njofton anëtarët e KZAZ-së për trajnim, në lidhje me procedurat e zgjedhjeve | Pas konstituimit, sa më shpejt të jetë e mundur |
| Publikon listat pëfundimtare të zgjedhësve | 35 ditë para ditës së zgjedhjeve |
| Pranon kërkesat e zgjedhësve, nëse zgjedhësi ndodhet/nuk ndodhet në listë dhe dhënia e vërtetimeve, **model 05 R**, **model 06 R**, | Çdo ditë, sipas orarit të KZAZ-së deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve |
| Kontrolli dhe rregullimi i QV-ve për ditën e zgjedhjeve | Menjëherë pas konstituimit<br>deri në ora 06:00 të datës 23 qershor 2013 |
| Emëron anëtarët e KQV-ve | Jo më vonë se 3 qershor (Jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve) |
| Njofton anëtarët e KQV-ve për trajnim | Jo më vonë se 3 qershor (Jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve) |
| Emëron anëtarët e GNV-ve | Jo më vonë se 14 qershor (Jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve) |
| Njofton anëtarët e GNV-ve për trajnim | Jo më vonë se 14 qershor (Jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve) |
| Marrjen në dorëzim të të gjitha materialeve të nevojshme për KQV-të dhe GNV-të | deri 1(një) ditë para ditës së zgjedhjeve |
| Kontrolli i QV-ve ditën e zgjedhjeve të votimit | 23 qershor 2013, ora 6.00, hapja e QV-ve<br>Këtë proces lejohen ta vëzhgojnë edhe vëzhguesit |
| Njofton fillimin e procesit të votimit | ora 7.00 |
| Transmeton të dhënat e votimit | Çdo 3 orë |
| Mbarëvajtja e procesit të votimit, njoftohet KQZ dhe Inspektori Rajonal për çdo problem | Në çdo kohë |
| Informacion KQZ-së për mbylljen e procesit të votimit | Pas orës 19.30, v.42, dt.2.12.2010 |
| Fillimi i procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore në VNV: | (jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në QV)<br>Informacion KQZ-së për<br>-Rregullsinë e kutisë së fletëve të votimit dhe kutisë me materialet e votimit të marra në dorëzim nga KQV nr...., Ora..., data....06.2013 |
| Përfundimi i procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore në VNV | Informacion KQZ-së ...KQV nr….., Ora…….data |
| Fillimi i procesit të Numërimit të Votave (vendimi) | Pas marjes në dorëzim të të gjitha kutive me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit nga QV-të, në juridiksionin e saj. Shënohet Ora…….data |
| Mbarëvajtja e procesit të numërimit, njoftohet KQZ dhe Inspektori Rajonal për çdo problem | Në çdo kohë |
| Transmetimi i rezultateve për çdo qendër votimi | Pas plotësimit të tabelës së rezultateve për çdo QV<br>- Rezultatet e zgjedhjeve të çdo QV-je për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit |
| Transmetimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së | Pas plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së |
| Mbyllja e procesit të Numërimit të Votave | Ora 22.00, datë 24 qershor 2013 |

Pas konstituimit KZAZ-ja bën planifikimin e veprimtarisë së saj, duke përcaktuar edhe detyrat.

**Kujdes!** Detyrat e Inspektori Rajonal i gjeni të përcaktuara në n.10 të U.nr.1, dt.20.02.2009, ndërsa për plotësimin e vendeve vakante në KZAZ, referojuni n.29, 5, p.7, 8 të KZ dhe n.9, p.1 dhe p.2 të U. nr.2, dt.25.02.2009, i ndryshuar

## MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJA E KZAZ-SË





**Mbledhjet** e KZAZ-së janë publike dhe janë të vlefshme, kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve (katër) të KZAZ-së.

**Vendimet** në KZAZ merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së, nënshkruhen prej tyre, si dhe vulosen me vulën e Sekretarit të KZAZ-së. **Sekretari nuk ka të drejtë vote.**
**Secili** prej anëtarëve të KZAZ-së **krahas nënshkrimit të tij** në vendim, **shënon** votën "**pro**" **ose** "**kundër**", si dhe **arsyetimin përkatës**. Sekretari i KZAZ-së shënon në LPM rezultatet e votimit për çdo propozim. **Sekretari vulos çdo faqe të procesverbalit të mbajtur në LPM.**
KZAZ-ja është e detyruar, që të bëjë menjëherë publike, vendimet e marra dhe të dërgojë në KQZ një kopje të këtyre vendimeve. Vendimi i marrë detyrimisht regjistrohet në Regjistrin e Vendimeve të KZAZ-së nga sekretari i saj.

**Në rast se KZAZ**-ja **nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës**, **çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar**. Vendimi i KQZ-së është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KZAZ-ja.

## VENDIMET DHE DOKUMENTACIONI I PUNËS I KZAZ-SË

### Modelet e Vendimeve të KZAZ-së

Gjatë procesit zgjedhor (me përjashtim të numërimit të votave) KZAZ-ja merr këto vendime:

- **a.** Model 01 V: Vendim për propozimin e Kryetarit të KZAZ-së;
- **b.** Model 02 V: Vendim për propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ-së;
- **c.** Model 03 V: Vendim për emërimin e anëtarëve të KQV-së;
- **d.** Model 04 V: Vendim për emërimin e kryetarit dhe sekretarit të KQV-së;
- **e.** Model 05 V: Vendim për caktimin e grupeve të numërimit të votave;
- **ë.** Model 06 V: Vendim për emërimin e anëtarëve të grupit të numërimit;
- **f.** Model 07 V: Vendim për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KQV-së;
- **g.** Model 08 V: Vendim për shkarkimin e një anëtari të KQV-së;
- **h.** Model 09 V: Vendim për lirimin dhe emërimin e kryetarit dhe/ose sekretarit të KQV-së;

**Kujdes!** Ju mund t'u referoheni n.35, p.2, p.5 të KZ, n.19, p.1, p.2, n.20, p.2, p.3, n.23, p.2, p.5 të U. nr.2, dt.25.02.2009 për mbledhjet dhe vendimmarrjen e KZAZ-së.
Modelet e vendimeve dhe dokumentacionin e punës të KZAZ-së do t'i gjeni në v. nr.20, dt. 28.01.2013.


Vendime të KZAZ-së
Zgjedhjet për Kuvend të datës 23 Qershor 2013


Vendime të KZAZ-së
Zgjedhjet për Kuvend të datës 23 Qershor 2013

**Modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së:**




**-Model 01 R**: Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së. KZAZ-ja pasqyron në LPM:

- mbledhjet dhe veprimtarinë e përditshme të KZAZ-së;
- informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë, të cilat sipas rastit, i verifikon ato.

**- Model 02 R**: Regjistri i vendimeve të KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së regjistron vendimet e KZAZ-së, nga mbledhja e parë e saj deri në përfundim të procesit zgjedhor, sipas numrit rendor.

**- Model 03 R**: Regjistri i korrespondencës së KZAZ-së.Sekretari i KZAZ-së protokollon të gjitha kërkesat, ankesat

dhe njoftimet që i drejtohen KZAZ-së, si dhe çdo dokument tjetër që i adresohet në funksion të punës së saj të përditshme.

**- Model 04 R**: Procesverbal Konstatimi. Sekretari i KZAZ-së mban procesverbal konstatimi, ku shënohen të gjitha parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive të votimit nga KQV-ja në KZAZ dhe gjatë procesit të numërimit të votave në VNV.

**- Model 05 R:** Vërtetim për zgjedhësit që janë në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor. Në përputhje me *Model 05 R*, Sekretari, me kërkesë të zgjedhësit, jep vërtetime nëse ai/ajo *ndodhet* i/e regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor.



MODEL- 06 R

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ Nr _____ QARKU _____________

VËRTETIM

Vërtetohet se z/znj_________________________________, nuk ndodhet i/e regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve të Zonës së Administrimit Zgjedhor, Nr _____, Qarku __________________.

SEKRETARI I KZAZ-së
_______________________
(emër, mbiemër, firma)

VULA

Miratuar me Vendim të KQZ-së Nr. 20, datë 28.01.2013

**- Model 06 R**: Vërtetim për zgjedhësit që nuk janë në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor. Në përputhje me *Model 06 R*, Sekretari, me kërkesë të zgjedhësit, jep vërtetime nëse ai/ajo *nuk ndodhet* i/e regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor, për t'u përdorur nga zgjedhësi në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës.



MODEL- 05 R

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ Nr _____ QARKU _____________

VËRTETIM

Vërtetohet se z/znj_________________________________, ndodhet i/e regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve të Zonës së Administrimit Zgjedhor, Nr _____, Qarku ________________, Bashkia/Komuna____________________ me këto të dhëna:

| Nr.QV | Nr. rendor në listë | Kodi i banesës | Emri, Atësia, Mbiemri | Datëlindja |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

SEKRETARI I KZAZ-së
_______________________
(emër, mbiemër, firma)

VULA

Miratuar me Vendim të KQZ-së Nr 20, datë 28.01.2013

## III EMËRIMI I KQV-VE

KQV-ja është organ kolegjial. Ajo përbëhet nga shtatë anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit.
Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja.
Në gjysmën e KQV-ve anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, **kurse në gjysmën tjetër** zgjidhet **njëri nga anëtarët e KQV**-së, përfaqësues i partisë kryesore të **opozitës** parlamentare. **Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.**

Në KQV-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare.

**Propozimet** për anëtarët dhe sekretarin e KQV-së bëhen **jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve.** Anëtarët dhe sekretari i KQV-së duhet të **emërohen jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e propozimeve të partive politike**. **Në çdo rast emërimi** i anëtarëve, kryetarit dhe sekretarit bëhet **jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.**

**Kujdes!** *Në çdo rast, sekretari i KQV-së propozohet nga partia e kundërt me partinë politike që ka propozuar Kryetarin e KQV-së. Kjo parti ka gjithashtu të drejtën të vendosë se cili prej dy kandidatëve të propozuar do të jetë sekretari i KQV-së.*




**Kujdes!** KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të n.29 të KZ për çdo lloj zgjedhjeje, me përjashtim të sh. "ç" të p.1 të këtij neni. Ju mund t'i referoheni n.36 të KZ. Të dhënat që përmban propozimi i partisë politike, për anëtar të KQV-së, përcaktohen në n.38 të KZ dhe n.4, p.2 të U.4, dt.9.3.2009.

Çdo anëtar i KQV-së duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- ka të paktën arsimin e mesëm;
- është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

- ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

*** Sekretari i KQV-së,**
**si rregull duhet të ketë arsimin e lartë.**



Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë:

- deputetë ose kandidatë për deputet në Kuvend;
- kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;

ose

- anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

**KUJDES!** Ju mund t'u referoheni n.36, dhe n.37, n.38 si dhe n.21, pika 9, n.39, p. 1, sh. "ç" të KZ, dhe n.4, p.1 e U. 4, dt. 09.03.2009, si dhe n.3 e 5 i U.4, dt.19.02.2013

**Shkarkimi, lirimi dhe plotësimi i vendit vakant të anëtarit dhe sekretarit të KQV-së**

**Shkarkimi i anëtarëve dhe Sekretarit të KQV-së**

Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

- shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij
- dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 (dy) ditë rresht ose
- nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

Propozimi për shkarkimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së mund të bëhet nga çdo subjekt zgjedhor. Propozuesit në të gjitha rastet duhet të paraqesin në KZAZ-në përkatëse së bashku me propozimin edhe provat mbi të cilat mbështesin propozimin për shkarkim. KZAZ-ja merr vendim për shkarkimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së, kur votojnë "pro" shumica e anëtarëve të saj.
**Anëtari dhe sekretari i KQV-së, i shkarkuar nga detyra me vendim të KZAZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.**

**Kujdes!** Për shkarkimin e anëtarit/sekretarit të KQV-së mund t'i referoheni n.35, p.4 (**kushtet e konfliktit të interesit**) dhe n.39 të KZ, ndërsa për propozimin e ri, KZAZ-ja respekton kërkesat e neneve 29, 36 e në vijim të KZ

**Lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së**

Anëtarët dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

- janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- kanë marrëdhënie të ngushtë familjarë ose martesore me kandidatët, që konkurojnë në zonë
- japin dorëheqjen nga detyra;
- nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

**Plotësimi i vendeve vakante të krijuara në KQV**

**Kur vendi i një anëtari të KQV-së** për çfarëdolloj shkaku **mbetet vakant**, KZAZ-ja i kërkon degës lokale të partisë politike përkatëse (anëtar i së cilës është shkarkuar apo liruar nga detyra) të paraqesë propozimin për **anëtarin** e **ri**, i cili duhet të **emërohet brenda 3 (tri) ditëve nga data e krijimit të vendit të lirë**, por **jo me vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit**.

| |
|---|
| **Kujdes**: **KZAZ**-ja **emëron anëtarët e KQV-së**, n.33, sh."b", sipas rastit, **për të plotësuar vendin vakant**, sipas n.36 të KZ, **me emrat nga lista e miratuar nga KQZ**, duke i dhënë përparësi trajnimeve në fushën e zgjedhjeve, eksperiencave të mëparshme në administratën zgjedhore dhe kualifikimeve profesionale n.3, p.2 dhe 3 e U.4, dt.19.02.2013. |

**Kur vendi i anëtarit të KQV-së mbetet vakant ditën e votimit**, **zëvendësimi** i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve ose që nuk paraqiten në detyrë në ditën e zgjedhjeve, bëhet **jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës.**

Kur KQV-ja **mbetet pa kuorum**, **për shkak mungesave të anëtarëve** dhe **me kalimin e afatit**, **nuk është kryer zëvendësimi**, **KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave** dhe **merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës**.

**Zëvendësimi** i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, **si rregull**, **me persona**, **të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor**.

**KQV-TË E POSAÇME, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TYRE**

KQV-të e posaçme ngrihen në institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë. Kryetari i Njësisë së Qeverisë Vendore ngre qendra votimi në institucione të posaçme, të cilët ndodhen brenda territorit të njësisë vendore përkatëse, kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ-në dhe KZAZ-në për ngritjen e këtyre qendrave të votimit.

| |
|---|
| **KUJDES!** Ju mund t'u referoheni nenit 43 të Kodit Zgjedhor. |

## IV VERIFIKIMI I AMBIENTEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT TË NGRITURA NË ZAZ

Mjediset e qendrave të votimit duhet të kenë madhësi të përshtatshme, që të lejojnë zhvillimin e duhur të procesit të votimit. Aty ku është e mundur, duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar. Vendndodhja e Qendrave të Votimit, private, përcaktohet me vendim të KQZ-së, në bazë të propozimit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore.

| |
|---|
| **KUJDES!** Ju mund të gjeni referencën ligjore që trajton caktimin e zonave të qendrave të votimit dhe vendndodhjen e tyre në n.62, 93 dhe 108, p.7 të KZ për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë dhe n.14, p.6 e U. nr.2, dt.25.02.2009 i KQZ-së |

Më poshtë paraqitet një tabelë – **shembull**, që mund të ndihmojë KZAZ-në në verifikimin e ambjenteve, në bazë të kritereve objektivë:

| NR | ÇËSHTJE | PO | JO | VEPRIME QË DUHET TË KRYHEN |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Karakteristikat e jashtme të vendit** | | | |
| | ▪ A janë dyshemetë/korridoret të sigurta dhe a është gjerësia e tyre e mjaftueshme? (minimumi 1.2 m*) | | | shënohen përmasat |
| | ▪ A ndodhen rampa në afërsi të hyrjes? | | - | njoftohet kom/bashkia |
| | ▪ A ndodhet hyrja në kat të parë dhe a është ajo me gjerësi të mjaftueshme? (minimumi 1.2 m*) | | | shënohen përmasat |
| | ▪ Nëse nuk ka rampa, të bëhet e mundur sigurimi i rampave të lëvizshme. | | - | njoftohet kom/bashkia/KQZ |
| | ▪ A ka hapësirë për parkim për personat me aftësi të kufizuar që mbërrijnë pranë QV me automjetin e tyre? | | + | |
| 2 | **Hyrjet në Qendrat e Votimit**<br>**▪ A ka prag/rampa të lëvizshme në hyrjen e Qendrës së Votimit?** | | | |
| | ▪ A ka hyrja gjerësi të mjaftueshme? (minimumi 1.2 m*) | | - | shënohen përmasat |
| | ▪ Nëse "Jo", a ndodhet hyrje tjetër alternative për personat me aftësi të kufizuar që përdorin karrige me rrota? | + | | |
| | ▪ A ka ndriçim të mjaftueshëm në hyrje? | | - | njoftohet kom/bashkia |
| 3 | **Korridoret e brendshme drejt vendit të votimit (nëse ka)** | | | |
| | ▪ A ndodhen dyer/mure në gjendje të tillë që mund të krijojnë rrezik? | | | |
| | ▪ A është korridori drejt vendit të votimit i parrëshqitshëm dhe me gjerësi të mjaftueshme (minimumi 1.2 m*)? | + | | |
| | ▪ A ndodhen pragje ose shkallë si pjesë e korridoreve drejt vendit të votimit? | | - | |
| | ▪ A është i mjaftueshëm ndriçimi përgjatë korridorit? | | - | njoftohet kom/bashkia/KQZ |
| 4 | **Veçori ndihmëse në vendin e votimit (lehtësira)** | | | |
| | ▪ A sigurohet hapësira e duhur për lëvizje të shpejtë dhe të lirshme për procesin e votimit? | + | | |
| | ▪ A është ndriçimi efektiv? | + | | |
| | ▪ A ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur postera udhëzues për zgjedhësit në lidhje me rregullat gjatë proçesit të votimit? | | + | |
| * | *Për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar që përdorin karrige me rrota.* | + | | njoftohet kom/bashkia/KQZ |





**Kujdes: Çfarë nuk duhet të ndodhë!**

## V KREU VI-LISTA PËRFUNDIMTARE E ZGJEDHËSVE

### Lista përfundimtare e zgjedhësve dhe shpallja e saj

KZAZ-së i dërgohet e printuar nga kryetari njësisë së qeverisjes vendore (bashkisë/komunës) **lista përfundimtare e zgjedhësve**, në **tre formate**, **jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve**, si më poshtë:

1. listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit. Kjo listë shpallet nga KZAZ-ja pranë çdo qendre votimi në një vend publik me hyrje të lirë, jo më vonë se 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve;

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**QARKU: Berat**
**Bashkia/Komuna: Berat**
**Qendra e votimit Nr. 3298**
**AdresaQV: Lagjia "Barrikadave", Shkolla"Z.Toska"**

**LISTA E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME**
**PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**
**DATA E ZGJEDHJEVE: 14/07/2013**
**Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë i datës: 06/11/2012**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Atesia | Datelindja | Kodi i vendbanimit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Kodi i lagjes | Kodi i Q.V. | Numri i ndertesës |
| 1 | Besar | Abazaj | Bujar | 11 / 08 / 1990 | 002 | 3298 | 001 |
| 2 | Besnike | Abazaj | Faslli | 05 / 05 / 1965 | 002 | 3298 | 001 |
| 3 | Jetnor | Abazaj | Agim | 03 / 12 / 1984 | 002 | 3298 | 003 |
| 4 | Qerime | Abazaj | Vesel | 15 / 04 / 1938 | 002 | 3298 | 001 |
| 5 | Xhuljeta | Abazaj | Refit | 01 / 12 / 1961 | 002 | 3298 | 003 |
| 6 | Bujar | Abazi | Idajet | 23 / 02 / 1961 | 002 | 3298 | 001 |

Përgjegjësi i zyres se gjendjes civile

Kryetari i Bashkise/Komunes

VULA

15/10/2012 Formati A, Lista e zgjedhesve për tu shpallur pranë çdo QV

2. listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit (**kjo listë i dorëzohet KQV-së** përkatëse bashkë me materialet e tjera të votimit nga KZAZ-ja për t'u përdorur nga KQV-ja në ditën e zgjedhjeve). Ky format përmban **edhe hapësirën për shënimin e numrit të dokumentit të identifikimit, si dhe vendin për nënshkrimin e zgjedhësit**;

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**QARKU: Berat**
**Bashkia/Komuna: Berat**
**Qendra e votimit Nr. 3298**
**AdresaQV: Lagjia "Barrikadave", Shkolla"Z.Toska"**

**LISTA E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME**
**PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**
**DATA E ZGJEDHJEVE: 14/07/2013**
**Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë i datës: 06/11/2012**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Atesia | Datelindja | Kodi i vendbanimit | | | Numri personal i identifikimit | Lloji/Numri i dokumentit | Nënshkrimi i zgjedhësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Kodi i lagjes | Kodi i Q.V. | Numri i ndertesës | | | |
| 1 | Besar | Abazaj | Bujar | 11 / 08 / 1990 | 002 | 3298 | 001 | J00811065J | | |
| 2 | Besnike | Abazaj | Faslli | 05 / 05 / 1965 | 002 | 3298 | 001 | G55505086E | | |
| 3 | Jetnor | Abazaj | Agim | 03 / 12 / 1984 | 002 | 3298 | 003 | I41203043S | | |
| 4 | Qerime | Abazaj | Vesel | 15 / 04 / 1938 | 002 | 3298 | 001 | D80415047I | | |
| 5 | Xhuljeta | Abazaj | Refit | 01 / 12 / 1961 | 002 | 3298 | 003 | G16201068D | | |
| 6 | Bujar | Abazi | Idajet | 23 / 02 / 1961 | 002 | 3298 | 001 | G10223048N | | |
| 7 | Edlira | Abazi | Agim | 20 / 01 / 1970 | 002 | 3298 | 000 | H00120327B | | |
| 8 | Elton | Aga | Përparim | 17 / 01 / 1981 | 002 | 3298 | 174 | I10117057E | | |
| 9 | Blerina | Ajdini | Avdyl | 13 / 04 / 1974 | 002 | 3298 | 000 | H45413084C | | |
| 10 | Altin | Allaj | Lame | 25 / 02 / 1971 | 002 | 3298 | 047 | H10225073F | | |
| 11 | Belina | Allaj | Qerim | 09 / 06 / 1974 | 002 | 3298 | 047 | H45609049A | | |
| 12 | Esmeralda | Allaj | Mitat | 18 / 09 / 1980 | 002 | 3298 | 047 | I05918058J | | |
| 13 | Ferdinant | Allaj | Lame | 05 / 06 / 1968 | 002 | 3298 | 047 | G80605079O | | |
| 14 | Lindita | Ashnaze | Mihal | 31 / 01 / 1973 | 002 | 3298 | 055 | H35131036R | | |
| 15 | Bashkim | Baçe | Harun | 22 / 12 / 1959 | 002 | 3298 | 171 | F91222094D | | |
| 16 | Ervehe | Baçe | Aguah | 28 / 05 / 1961 | 002 | 3298 | 171 | G15528075I | | |
| 17 | Fatbardha | Baçe | Sherif | 05 / 07 / 1952 | 002 | 3298 | 171 | J25703050A | | |
| 18 | Harun | Baçe | Bashkim | 20 / 10 / 1982 | 002 | 3298 | 171 | I21020065K | | |
| 19 | Klajdi | Baçe | Bashkim | 20 / 09 / 1984 | 002 | 3298 | 171 | I40920064K | | |
| 20 | Agron | Bare | Gani | 21 / 05 / 1969 | 002 | 3298 | 123 | G90521042S | | |
| 21 | Anila | Bare | Enver | 05 / 08 / 1978 | 002 | 3298 | 123 | H85805059U | | |
| 22 | Gani | Bare | Sabet | 10 / 04 / 1940 | 002 | 3298 | 123 | E00410064C | | |
| 23 | Nadire | Bare | Hasan | 27 / 05 / 1947 | 002 | 3298 | 123 | E75527017E | | |
| 24 | Ajet | Beqiraj | Rushit | 10 / 04 / 1946 | 002 | 3298 | 000 | E60410039E | | |

Përgjegjësi i zyres se gjendjes civile

Kryetari i Bashkise/Komunes

VULA

15/10/2012 Formati B, Liste per tu perdorur nga KQV

3. listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore. Ky format mbahet nga KZAZ-ja dhe për çdo rast shërben për informim të zgjedhësve.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**QARKU: Berat**
**Bashkia/Komuna: Berat**

**LISTA E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME**
**PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**
**DATA E ZGJEDHJEVE: 14/07/2013**
**Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë i datës: 06/11/2012**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Atesia | Datelindja | Kodi i vendbanimit | | | Kodi i Q.V. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Kodi i lagjes | Kodi i Q.V. | Numri i ndertesës | |
| 1 | Elona | Aaron | Dhimitër | 19 / 05 / 1986 | 002 | 3311 | 145 | 3311 |
| 1 | Albano | Abazaj | Xhemil | 05 / 07 / 1991 | 002 | 3307 | 146 | 3307 |
| 1 | Alketa | Abazaj | Ramadan | 20 / 11 / 1972 | 002 | 3303 | 009 | 3303 |
| 2 | Beqir | Abazaj | Myslim | 28 / 04 / 1947 | 002 | 3307 | 146 | 3307 |
| 1 | Besar | Abazaj | Bujar | 11 / 08 / 1990 | 002 | 3298 | 001 | 3298 |
| 2 | Besnike | Abazaj | Faslli | 05 / 05 / 1965 | 002 | 3298 | 001 | 3298 |
| 3 | Bledar | Abazaj | Beqir | 22 / 05 / 1982 | 002 | 3307 | 146 | 3307 |
| 4 | Eleni | Abazaj | Haxhi | 02 / 09 / 1951 | 002 | 3307 | 146 | 3307 |

Përgjegjësi i zyres se gjendjes civile

Kryetari i Bashkise/Komunes

VULA

15/10/2012 Formati C, Liste per tu perdorur nga KZAZ

**Kujdes!**. Ju mund t'i referoheni n.48, 55, 56 dhe 57, p.2 të KZ

**Zgjedhësi, që nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve** n. 57, p.1

Zgjedhësit kur vërejne se emri i tyre nuk është përfshirë në Listën Përfundimtare të Zgjedhësve të QV-së, fillimisht i drejtohet KZAZ-së për të kontrolluar në listën përkatëse të zgjedhësve të zonës zgjedhore.
Në çdo rast Sekretari i KZAZ-së me kërkesë të zgjedhësit të interesuar, lëshon vërtetim, kur emri i zgjedhësit ndodhet ose nuk ndodhet i regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor.

Zgjedhësi/sja ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, kur vëren se:

- ka pasaktësi të përbërësve të tij/saj zgjedhorë;
- nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore (bashki/komunë/njësi bashkiake), ku ai/ajo ka vendbanimin

**Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë** dhe **vendosin** në lidhje me këto kërkesa **edhe në ditën e zgjedhjeve**, por **jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit.**





| |
|---|
| **Kujdes! Çdo shtetas shqiptar**, **që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve**, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike, ose gjendje ekonomike **ka të drejtë të votojë**. Ju mund t’i referoheni n.3, 56 dhe 57 të KZ. |

## VI PËRGATITJA DHE ORGANIZIMI I VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

### 1.Përgatitja e VNV




KZAZ-ja organizon dhe përgatit VNV. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, **jo më vonë se 40 ditë ditë nga data e zgjedhjeve**. Si rregull i përgjithshëm, VNV nuk mund të krijohet në ndërtesa private pa autorizimin e KQZ-së, në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të ndërtesave publike, të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore, si: pallat sporti, pallat kulture, qendër kulturore e fëmijëve, palestra sportive, salla kinemaje, ambiente të përshtatshme shkollash, etj. Ato nuk mund të krijohen në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike apo kandidati ose të afërmve të tij ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.

Në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, **KZAZ-ja merr** masa për të marrë **në dorëzim Vendet e Numërimit të Votave**, jo më vonë se **10 ditë para ditës së zgjedhjeve**. Mjediset e identifikuara për ngritjen e VNV-ve duhet të kenë madhësi të përshtatshme, që të lejojnë zhvillimin e duhur të procesit të numërimit të votave duke përfshirë vendosjen e teknologjisë mbështetëse dhe pajisjeve të nevojshme. Madhësia e VNV-ve varet nga numri i QV-ve në atë zonë:

- 79 QV → sipërfaqja e VNV → 200 m2
- mbi 79 QV → sipërfaqja e VNV → 300 m2

Ndërtesat e VNV duhet të kenë:

- ndriçim dhe energji elektrike të mjaftueshme për teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave;
- më shumë se një derë, për komunikimin me mjedisin e jashtëm;
- ndarjen e hapësirës së publikut nga zona e numërimit të votave;
- paisje me mjete mbrojtje kundra zjarrit si dhe të ndihmës së shpejtë

Pajisjet e nevojshme:

| | Tavolina | Karrige | Kompjuter | Printer | Fotokopje | Tel/Fax |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KZAZ | 2 | 8 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Ndihmësi teknik | 1 | 2 | | | | |
| Për çdo GN | 1 | 4 | | | | |

**Tabela 1**

**Kujdes:** Ju mund t'i referoheni n.93,p.1,2,3 dhe n.94 të KZ, n.2, n.3, n.4, n.5 të U.12 dhe n.14, p.3 e U. nr.2

**KUJDES:** Ju mund t'i referoheni n.94, p.2 e KZ, n.2, p.5, n.5, p.4 e U. nr.12 dhe n.3, p.2 të U. nr.18

KZAZ-ja i vendos tavolinat e punës për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato:

- të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave;
- të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZAZ-së, vëzhguesit, kandidatët, përfaqësuesit e akredituar të medias;
- të mundësojnë aplikimin e teknologjisë mbështetëse, ku të shfaqen qartë fletët e votimit në monitorët e instaluar;
- të parandalojnë ndërhyrjen e personave të paautorizuar



**Vëzhguesit qendrojnë përballë grupeve të numërimit** në një largësi të vogël nga tryezat e punës, **përballë monitorëve.** Vëzhguesit **nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit.**

**Kujdes:** VNV-ja duhet të ketë infrastrukturën logjistike për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave dhe KZAZ-ja, **jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve**, fton për njohje të VNV-së subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve. n.94, p.1 e KZ
*-Regjistrimi filmik i procesit ruhet në mënyrë elektronike dhe dorëzohet në KQZ* ***së bashku*** *me materialet e tjera zgjedhore* Ju mund t'i referoheni n.94, p.4 e KZ dhe n.9, n.10 të U. nr.18

## VII GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

**Caktimi i Grupeve dhe Tavolinave të Numërimit të Votave**

KZAZ-ja përcakton Grupet e Numërimit dhe Tavolinat e Numërimit në ZAZ (Tabela 2).

| QV | GN |
|---|---|
| Deri në 79 | 5-10 |
| 80-100 | 6-12 |
| 101-120 | 7-14 |
| 121-140 | 9-18 |
| Mbi 140 | 10-20 |

**Tabela 2**

GN-it janë 2 për çdo tavolinë numërimi. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi.

KZAZ-ja:

- njofton me shkrim partitë politike, të cilave i ka lindur e drejta të propozojnë anëtar të GN-it, **15 ditë para ditës së zgjedhjeve**, për numrin e GNV-ve që do të ngrejë;
- u kërkon atyre të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën **dymbëdhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve**

**Kujdes**: Ju mund t'i referoheni n.95, p.1 e KZ dhe n.6, n.7 dhe n. 8, p.1 e U.nr.12




Çdo person mund të emërohet anëtar dhe sekretar i GNV-së, nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

**a.** gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
**b.** ka arsimin e lartë;
**c.** është me vendbanim brenda zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatës;
**d.** nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
**e.** ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Anëtari dhe sekretari i Grupit të Numërimit të Votave nuk mund të jetë:

- deputet apo kandidat për deputet në Kuvend
- ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtëtëror
- anëtar apo sekretar të një grupi tjetër numërimi.

KZAZ-ja, **jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve** merr vendim për emërimin e anëtarëve të GN-ve.

| |
|---|
| **Kujdes**: Ju mund t'i referoheni n.30, n.31 të KZ dhe n.11 dhe n.12 të U.nr.12 |

GNV-të përbëhen nga katër anëtarë. KZAZ-ja cakton një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar.

Në **gjysmën** e Grupeve të Numërimit të Votave **numëruesi i parë** propozohet nga partia më e madhe e shumicës dhe në **gjysmën** tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Sekretari i Grupit të Numërimit të Votave i përket partisë politike **të kundërt** me partinë që propozon numëruesin e parë.

KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e GN-it, sipas procedurës:

**a.**Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "tek" dhe sekretarin e grupeve "çift".

**b.**Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "çift" dhe sekretarin e grupeve "tek".

Anëtari i tretë dhe i katërt i GNV-ve, përcaktohen me short në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë.

Nëse ndonjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik.

| |
|---|
| **Kujdes**: Ju mund t'i referoheni n.29, pika 1/a, n.95, p.2,3 paragrafi 2, n.96 të KZ, v.20, dt.28.01.2013 dhe n.9, n.10 i U.nr.12 |

**Në rast se ndonjë nga subjektet zgjedhore nuk paraqet** propozime brenda të paktën **dymbëdhjetë ditëve para ditës së zgjedhjeve**, **KZAZ**-ja cakton me **short anëtarët zëvendësues** të cilët i përkasin së njëjtës parti. **Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon** me **jo më pak se dy anëtarë.**

| |
|---|
| **Zëvendësimi i anëtarëve të GN-it dhe procedura e shortit për zëvendësimin e tyre është e përcaktuar në n.13 dhe n.14 të U. nr.12.** |

Në rastet kur vendi i një anëtari të Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri, pavarësisht nga ky fakt, procesi i numërimit të votave vazhdon pa ndërprerje.

Nëse partia politike nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur bosh brenda 1 ore, KZAZ-ja zbaton procedurën e shortit.

| |
|---|
| **KUJDES**: Ju mund t'i referoheni n.14, n.15, p.2 të U.nr.12 |

## VIII DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KQZ PËR KZAZ, KQV dhe GN
### Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KZAZ

KQZ-ja dërgon në KZAZ, **jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve**, materialet zgjedhore të futura në kuti të veçanta ambalazhi (me përjashtim të dhomave të fshehta, që dorëzohen më vete):

**i. Kuti e veçantë me materiale zgjedhore, që administrohet vetëm nga KZAZ-ja ku përfshihen edhe materialet zgjedhore për grupet e numërimit**




**ii. Kuti e veçantë me materiale zgjedhore për çdo Qendër Votimi**






**KUJDES!** Mund t'i referoheni n. 99 i KZ, V.11, dt.10.01.2013, n.10, p.2 e U. nr. 5

Procesverbalet që përdoren për dorëzimin e materialeve zgjedhore janë sipas modeleve, si më poshtë:

**i. PV - KZAZ - 02**, materialet zgjedhore për KZAZ-në dhe dokumentacionin zgjedhor.

- Tabela e Rezultateve për QV-të Model - 57-13;



QARKU__________

GN NR _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ NR ___

TABELË E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Numri i zgjedhësve që kanë votuar | | |
| 2 | Fletë votimi të papërdorura | | |
| 3 | Fletë votimi të dëmtuara | | |
| 4 | Fletë votimi të gjetura në kuti | | |
| 5 | Vota të pavlefshme | | |
| 6 | Vota të vlefshme | | |

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

| Nr. | Subjektet Zgjedhore | Numri i votave të vlefshme | |
|---|---|---|---|

Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)

1. Unë ______________, anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ______________

2. Unë ______________, anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ______________

3. Unë ______________, anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ______________

| Nr. | Numri i kodeve të vulave që mbyllin kutinë e votimit |
|---|---|
| 1 | |
| 2 | |
| 3 | |
| 4 | |
| 5 | |

Data e plotësimit___.06.2013

Grupi i Numërimit Nr.___

| Nr. | Emri, Atësia, Mbiemri | Funksioni | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | | Numërues i parë | |
| 2 | | Sekretar | |
| 3 | | Anëtar | |
| 4 | | Anëtar | |

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, 23.06. 2013

- Tabela e Rezultateve Përmbledhëse– Model 40-13;








- Model Zarfi (Z.04 Z.05 Z.06)
- Boje matrikulluese

- Vula (kode) sigurie për GN-të; Vula (kode) sigurie rezervë;





- Pinca për këputjen e vulave të sigurisë;
- Makinë llogaritëse;
- Shirit ndarës për VNV-në;
- Bazament (druri) kryq për organizimin e VNV-së;
- Element (druri) ndarës për identifikimin e GN-së;

Paketa e materialeve zgjedhore (e shoqëruar me fletën e iventar) të dorëzohet në KQZ..



**ii. PV - KZAZ - 03**, materialet zgjedhore për KQV-të (n. 99, n. 100, p. 1)

- Procesverbal i vulosjes së kutive të votimit, **model PV- KQV 07**;
- Procesverbal i mbylljes së votimit, **model PV- KQV 08**;



- Vulat e KQV-së;
- Vulat për kryetarët e KQV-ve;



Kuti votimi;




Kutia e Materialeve Zgjedhore;




- Vula (kode) sigurie;
- Set i zarfave të sigurisë:
- Boja Matrikulluese
- Zarfi i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit, Z.01;
- Zarfi i fletëve të votimit të papërdorura, Z.02;
- Zarfi i fletëve të votimit të dëmtuara Z.03;
- Dhoma të fshehta;
- Dhoma të fshehta për personat me aftësi të kufizuar; Paketë kancelerike e materialeve zgjedhore.





**iii. PV - KZAZ - 04**, për fletët e votimit për çdo KQV.
Fletët e votimit dërgohen në çdo KZAZ, e cila i shpërndan në qendrat e votimit nën jurisdiksionin e saj. Fletët e votimit të futura në këtë kuti nuk verifikohen nga KZAZ-ja, megjithatë procesverbali i dorëzimit të fletëve të votimit, **model PV-KZAZ-04**, nga KQZ në KZAZ, për çdo QV në juridiksionin e saj, **mbahet në dy kopje** dhe firmoset rregullisht nga dorëzuesi (punonjësi i KQZ-së) dhe nga marrësi (kryetar, zv.kryetar, sekretar i KZAZ-së).

**Fleta e Votimit**





**Fleta e votimit Qarku FIER**

**Kujdes**: Në **PV-KZAZ-04 duhet** të shënohen numrat e serisë së bllokut të fletëve të votimit. Numri i fletëve të votimit për subjektet zgjedhore, do të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë, duke i shtuar 2%. Mund t'i referoheni n. 97, p.4 dhe n.99, p.1, sh."a" të KZ.

**Kujdes**: Procesverbalet model: **PV-KQV-05, PV-KQV-07, PV-KQV-08, PV-KQV-08-T, Modelin PV-KZAZ-06, Modelin PV-KZAZ-09** **nuk duhet të përmbajnë** fjalën **"zv/kryetar"**

### Materialet zgjedhore për GN-të

Materialet që i dërgohen KZAZ-së për GNV-të përcaktohen sipas një inventari, të ndara, si vijon:

**A.Dokumentacioni i punës:**

- Kod Zgjedhor
- Manual
- Tabelë e rezultateve për QV-të
- Procesverbal i mbylljes së Kutisë së Materialeve zgjedhore (Votimit) **Model PV-GNV-10**
- Procesverbal i Grupit të Numërimit të votave për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara **Model PV-GN-10-1**

**B.Set i kancelarive:**

- Shenjë dalluese për GN
- Pincë për këputjen e kodeve të sigurisë
- Dosje me llastik
- Kartë identiteti
- Letër A4
- Stilolaps
- Kode/vula metalike
- Makinë llogaritëse
- Qirinj
- Zarfa sigurie për fletë votimi të kontestuara, Z.04;
- Zarfa sigurie për fletë votimi të pavlefshme, Z.05;



- Zarfa për fletë votimi për secilin subjekt Z.06;
- Zarfi " vota të vlerësuara nga "SEN-i" (për qarkun **Fier**) Z.04-F;
- Zarfi " vota të kontestuara nga "SEN-i" (për qarkun **Fier**) Z.06-F;

**Kujdes**: Mund t'i referoheni V.10, dt.10.01.2013 të KQZ, n. 7, n. 9, n.10 dhe sh."a", "b" të listës përbërëse të Aneksit 1 të U. nr. 5, dt.12.03.2009 si dhe v.95, dt.22.02.2011

**Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në çdo KQV**
KZAZ:

- Njofton çdo KQV për kohën e marrjes së materialeve zgjedhore, duke patur parasysh largësinë e saj nga vendndodhja e KZAZ-së,
- Merr masat për sigurimin e automjeteve për transportimin e materialeve zgjedhore për çdo KQV

KZAZ-ja shpërndan materialet zgjedhore **jo më vonë se 15 orë para Hapjes së Votimit.**



**Materiale zgjedhore jashtë kutisë, të cilat i dorëzohen KQV-së nga KZAZ-ja:**

**a-Lista e zgjedhësve të QV-së**
**b- Vulat metalike me kodet e sigurisë për kutinë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore**
**c. Vula e KQV-së e vendosur në një zarf të mbyllur (e vulosur nga Ministria e Brendshme)**
**d- Vula për Kryetarin e KQV-së**
**Kryetari i KQV**-së përkatëse **në praninë e anëtarëve të KZAZ-së**, **kryen** sipas radhës **veprimet** e mëposhtme:

- merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara.
- gris ambalazhin e vulës,
- vulos, në një letër të bardhë, modelin e krahasimit të vulës,





- shënon **me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij**, si dhe **nënshkruan** poshtë vulës në prani të anëtarëve të KZAZ

- **Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimeni) të Vulës së Kryetarit të KQV-së** dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë së bashku me **Modelin PV-KZAZ-06**.

## IX VEPRIME TË KZAZ-së GJATË DITËS SË ZGJEDHJEVE

Gjatë ditës së votimit KZAZ-ja drejton procesin zgjedhor nga ambjenti i caktuar si VNV. Në rast se ka ndonjë problem gjatë procesit të votimit, KZAZ-ja cakton një grup pune me dy anëtarë (një nga partia e shumicës parlamentare, një nga partia e opozitës parlamentare) për verifikimin dhe zgjidhjen e problemit që ngrihet nga KQV-ja.

**Kujdes**: Në çdo rast në KZAZ duhet të jenë të pranishëm 4 anëtarët e tjerë të saj, pozitë-opozitë, me të drejtë vote

KZAZ-ja mban kontakte të vazhdueshme me KQZ-në dhe jep informacion në lidhje me:

- fillimin dhe ecurinë e procesit të votimit,
- plotësimin e vendeve vakant, të krijuara në KQV gjatë ditës së votimit, etj.
- pjesëmarrjen në votime numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në QV dhe sa nga këta votues janë femra - ora 19.30

- drejton transportin e materialeve zgjedhore nga anëtarët e KQV-së, menjëherë pas mbylljes së votimit;
- organizon marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV-të;
- shqyrton menjëherë ankesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore apo nga anëtarë të KQV-së, në rastet kur KQV-ja nuk ka arritur të marrë vendim lidhur me ecurinë e procesit të votimit.

**Kujdes**: Mund t'i referoheni n.33, n.42, p.5, n.115, p.1 të KZ, n.14, p.5; n.23, p.6 e U.nr.2 dhe v. nr.42, dt.02.12.2010

**Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje**

Sekretari i KZAZ-së, nëpërmjet ndihmësit të tij teknik, çdo tre orë pas hapjes së votimit, kërkon dhe merr nga sekretari i KQV-së përkatëse numrin e zgjedhësve, që kanë votuar deri në atë moment. Në mbylljen e votimit KZAZ i kërkon KQV-së veç numrit të përgjithshëm të zgjedhësve, që kanë votuar në atë QV edhe sa nga këta votues janë femra.

Ndihmësi teknik shënon shifrat në kompjuterin e KZAZ-së. Jo më vonë se 30 minuta nga koha për marrjen e informacionit nga qendrat e votimit (pra, jo më vonë se ora 10-30, 13-30, 16-30 dhe 19-30), KZAZ njofton në KQZ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar deri në atë moment, duke dhënë, në se ka, dhe QV-të që për ndonjë arsye nuk kanë dhënë informacion.





Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje gjatë ditës së votimit jepet me mesazh zanor me anë të telefonit celular dhe kur është e mundur edhe në rrugë elektronike.

**Kujdes:** Ju mund t'i referoheni v. nr.42, dt.02.12.2010





->




->

**Shembull**: **Hedhja e të dhënave për transmetimin e informacionit**
Qarku ________

KZAZ Nr._____

| | | | | Pjesëmarrja në votim ditën e zgjedhjeve | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NR. | Njësia | QV NR. | Zgjedhës | ora 10-00 | ora 13-00 | ora 16-00 | ora 19-00 | |
| | | | | Gjithsej | Gjithsej | Gjithsej | Gjithsej | Femra |
| 1 | Kuçovë | 3515 | 990 | | | | | |
| 2 | | 3516 | 866 | | | | | |
| 3 | | 35161 | 711 | | | | | |
| 4 | | 3517 | 999 | | | | | |
| 5 | | 3518 | 1000 | | | | | |
| 6 | | 3519 | 1000 | | | | | |
| 7 | | 35191 | 688 | | | | | |
| 8 | | 3520 | 845 | | | | | |
| 9 | | 3521 | 689 | | | | | |
| 10 | | 35253 | 776 | | | | | |
| … | | …. | …. | | | | | |
| Shuma njesi | | | | | | | | |
| 11 | Kozare | 3492 | 787 | | | | | |
| … | | … | … | | | | | |
| Shuma njesi | | | | | | | | |
| 12 | Perondi | 3505 | 875 | | | | | |
| … | | | | | | | | |
| Shuma ZAZ | | | | | | | | |

**Lidhja 1 e V. nr.42**

**Kujdes: Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga KQV-të dhe organizimi i procesit të numërimit të votave trajtohen në mënyrë të posaçme në dy manuale të tjera të KQZ-së.**

## X PAS ZGJEDHJEVE - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KQZ

Menjëherë pas përfundimit të proçedurave të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së dorëzon veçmas:

- **Model 40-13** Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së (të cilën e nxjerr KZAZ);
- **Model 40-13 V** Vendim "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës së Administrimit Zgjedhor" për Zgjedhjet për Kuvend";

- **Model 57-13** "Tabelë e Rezultateve për Qendrën e Votimit" (të cilën e nxjerr GNV);
- Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM); Libër Protokolli
- Procesverbalin e Konstatimit;
- Vulën e KZAZ-së;
- Regjistrin e Vendimeve KZAZ-së;
- Regjistrin e Korrespondencës.
- **Vendimet për emërimin e KQV-ve**;
- Kutitë e votimit me fletët e votimit me **PV–KZAZ-13**;
- Kutitë e materialeve zgjedhore me **PV–KZAZ-13**;
- Materialet zgjedhore të inventarizuara me **PV-KZAZ –11:**
    - Telefaks;
    - Makinë llogaritëse;
    - Pinca metalike;





- Këmbë druri me bazament kryqi
- Aparat fotokopje
- Elemente ndarëse për tavolinat e numërimit

Gjithashtu, **brenda 3 muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve,** KZAZ dorëzon në ZRAD, dokumentet origjinale:
-Listën e emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së, KQV-ve, GNV-ve
- listën e qendrave të votimit;
- listën e zgjedhësve për Zonën Zgjedhore;
- Hartën e Zonës Zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;
- Përshkrimin me shkrim të kufijve të të gjitha zonave të administrimit zgjedhor;
- Deklaratë të shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.
si dhe çdo dokumentacion tjetër zgjedhor.

**Kujdes:** ***Së bashku*** *me materialet e tjera zgjedhore dorëzoni në KQZ : Regjistrimin filmik të procesit të regjistrimit për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre dhe vlerësimit të çdo flete votimi, i cili ruhet në mënyrë elektronike*

KZAZ-ja është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të zgjedhjeve, materialeve zgjedhore. Asnjë procesverbal i KQV-së, GNV-së dhe KZAZ-së nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

**Kujdes**: Ju mund t'i referoheni n.178 të KZ, pikave 1, 3, 4 dhe V.nr 8 të KQZ-së, dt.10.01.2013 dhe n.13 të U.nr.5 dhe V.95

**Kujdes:** Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së. Nëse do të ketë raste të dëmtimit, thyerjes, apo humbjes së materialeve jo për faj të dorëzuesit, ju nuk do të mbani përgjegjësi financiare, vetëm nëse do të vërtetoni dëmin ekonomik me anë të një proces-verbali të vulosur dhe firmosur nga Kryetari, N/Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së. Për efekt verifikimi, ky procesverbal, **model PV-KZAZ –11**, mbahet në 3 (tre) kopje. Kopja origjinale *(faqja e parë)* e këtij proces-verbali do të dorëzohet në Zyrën e Financës, pranë KQZ-së, e cila do të bëjë edhe verifikimin e vlerës së materialeve të dorëzuara në KQZ pas përfundimit të procesit zgjedhor.

## XI - SHEMBUJ PRAKTIKË TË VEPRIMEVE TË KZAZ-SË

**i.Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse dëmtohet vula e KZAZ-së?**
Njofton me shkresë përcjellëse dhe/tel/fax, menjëherë, KQZ-në dhe Inspektorin e Zyrës Rajonale Zgjedhore (ZRZ).
Shkresa duhet të përmbajë këto elementë:

- Numrin e KZAZ-së;
- Njësinë e qeverisjes vendore;
- Qarkun;
- Datën dhe orën e dërgimit;
- Kujt i drejtohet KZAZ ?- KQZ dhe Inspektorit të ZRZ-së;
- Rrethanat e dëmtimit të vulës;
- Ora dhe data e dëmtimit të saj;
- Kërkon zëvendësimin e vulës së KZAZ-së me vulë të re;



- Shkresa duhet të jetë e vulosur (për të parë edhe sa është dëmtuar vula) dhe firmosur nga anëtarët e KZAZ-së dhe Sekretari i KZAZ-së, i cili shënon: "**Vula e dëmtuar**", përbri firmës së tij.

**Kujdes**:KZAZ vazhdon punën, shënon faktin konkret në LPM dhe Procesverbalin e Konstatimit

Për sa më sipër, Sekretari i KZAZ mban procesverbalin në LPM dhe kopje e tij i bashkëlidhet shkresës, e cila regjistrohet në Regjistrin e Korrespondencës. Kopja origjinale e shkresës mbahet në arkivin e KZAZ-së nga Sekretari i saj.





**ii.Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse vula e KQV-së dëmtohet gjatë votimit, ose humbet/ ose nxirret jashtë qendrës së votimit?**

Menjëherë njofton me shkresë përcjellëse dhe tel/fax, KQZ-në dhe Inspektorin ZRZ, si dhe Komisariatin përkatës të Policisë së Shtetit humbjen e vulës së KQV-së.
Shkresa duhet të ketë këto elementë:

- Numrin e KZAZ-së;
- Njësinë e qeverisjes vendore;
- Qarkun;
- Kujt i drejtohet KZAZ ?- KQZ-së, Inspektorit të ZRZ-së dhe Komisariatit të Policisë së Shtetit;
- Rrethanat e humbjes së vulës;
- Numrin e KQV-së;
- Kopje të procesverbalit të KQV-së;
- Kopje të vendimit të KQV-së "Për pezullimin e votimit"
- Kërkon zëvendësimin e vulës së dëmtuar gjatë votimit, ose humbur/ ose nxjerrë jashtë qendrës së votimit të KQV-së, nr.... , me vulë te re.
- Shkresa duhet të jetë e firmosur nga anëtarët e KZAZ-së dhe e vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

**Kujdes**: KQV pezullon votimin dhe menjëherë merr vendim "Për pezullimin e votimit".
KQV njofton menjëherë, me telefon (me të gjitha mënyrat e njoftimit) KZAZ-në, Inspektorin e ZRZ-së, që KQZ të marrë vendim për zëvendësimin e vulës.

**iii.** Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse një zgjedhës paraqet ankesë **"Sekretari i KZAZ-së nuk jep vërtetime, nëse emri i zgjedhësit ndodhet në listën e zgjedhësve"?**

Sekretari i KZAZ-së:
- regjistron (protokollon) ankesën në Regjistrin e Korrespondencës së KZAZ-së;
- vendos në ankesë numrin dhe datën e protokollit;
- njofton Kryetarin e KZAZ-së për ankesën;
- i jep sqarime Kryetarit të KZAZ-së lidhur me këtë ankesë.



Kryetari thërret mbledhjen e KZAZ-në. Sekretari njofton anëtarët e KZAZ-së.
Sekretari njofton anëtarët për mbledhjen. (**Kujdes**: Mbledhjet e KZAZ- thirren edhe nga zv.kryetari ose së paku nga dy anëtarë të saj) .
Gjatë mbledhjes Sekretari i KZAZ-së mban procesverbalin e mbledhjes, ku shënon orën, datën, objektin e ankesës dhe emrat e pjesëmarrësve në mbledhje. KZAZ verifikon listën e

zgjedhësve dhe nëse emri i zgjedhësit ndodhet në listë **KZAZ merr vendim dhe urdhëron Sekretarin e saj** të japë vërtetimin **(model 05 R) ankuesit** (zgjedhësit). Anëtarët e KZAZ-së pjesëmarrës në mbledhje firmosin procesverbalin duke vendosur "pro" ose "kundër" përbri nënshkrimit të tyre. Sekretari i KZAZ-së:
- vulos procesverbalin.
- zbardh vendimin,
- e regjistron atë në Regjistrin e vendimeve.
- shënon numrin dhe datën në vendim;
- e vulos vendimin, pasi anëtarët e KZAZ-së e kanë firmosur dhe vendosur "pro" përbri nënshkrimit të tyre (por **Kujdes**, jo më pak se katër anëtarë).
- i jep ankuesit (zgjedhësit) vërtetimin, **model 05 R**.

**Kujdes:** Nëse Sekretari i KZAZ-së e ka përsëritur veprimin e mosdhënies së vertetimeve **Model 05 R** dhe **Model 06 R**, secili nga anëtarët e KZAZ-së, për shkelje të detyrave, mund të informojë KQZ-në. Ky informacion mund të përbëjë shkak, që një nga subjektet zgjedhore t'i propozojë KQZ-së, për shkarkimin e Sekretarit të KZAZ-së.

**iv.** Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë **"Anëtari A.Z. i KQV-së nr...., ose Y.Z. i GN-it nuk plotëson një nga kushtet e n.38, sepse nuk është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse"?**

**A.** Ankuesi ka depozituar së bashku me ankesën edhe prova, dokumente që vërtetojnë se anëtari KQV-së ose GNV-së nuk plotëson një nga kushtet e n.38, p.1, sh."c";
KZAZ:
- duhet të shqyrtojë provat. Në këtë rast, prova, dokumenti është certifikata personale, të 30 ditëve të fundit, e cila provon se vendbanim i anëtarit të KQV-së ose GN-it nuk është brenda zonës zgjedhore përkatëse, përbën shkak për lirimin e tij nga detyra.
- merr vendim për lirimin e anëtarit të KQV-së ose GN-it;
- njofton subjektin zgjedhor (degën e partisë politike të rrethit përkatës) për zëvendësimin e anëtarit të KQV-së ose GN-it me një person tjetër;
**B.** Ankuesi nuk ka depozituar prova, dokumente që vërtetojnë se anëtari KQV-së ose GN-it nuk plotëson një nga kushtet e e n.38, p.1, sh."c";;

KZAZ:
- i kthen përgjigje me shkrim ankuesit dhe
- i kërkon atij, për të vërtetuar pretendimin, të depozitojë certifikatën personale, të 30 ditëve të fundit, pranë KZAZ-së.
Nëse pas depozitimit të saj rezulton se vendbanimi i anëtarit të KQV-së ose GN-it nuk është brenda zonës zgjedhore përkatëse, përbën shkak për lirimin e tij nga detyra.
**Kujdes:** KZAZ vazhdon procedurën si në rastin "**A**" dhe lidhur me procedurën e vendimmarrjes vepron si në shembullin "**iii**".

- Subjekti zgjedhor, duhet të paraqesë në KZAZ-në përkatëse, së bashku me propozimin edhe dokumentacionin e nevojshëm për anëtarin e ri të KQV-së ose GN-it:
- certifikatë personale;
- deftesë e shkollës mesme, në rastin e propozimit të anëtarit të KQV-së;
- diplomë e shkollës lartë, *Në rastin e propozimit të Sekretarit të KQV-së dhe anëtarit të GN-it;
- vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- deklaratë personale e tij, që nuk ka marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

**v.** Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë **"Anëtari A.ZH. i KQV-së nr..... bllokon procesin e votimi, me qëllim zvarritjen e tij, për të kaluar në pavlefshmëri të zgjedhjeve" ?**



**A.**KZAZ menjëherë:
- merr në shqyrtim ankesën;
- verifikon nëse është bllokuar procesi i votimit, me të gjitha mjetet (telefon dhe/ose dërgon në KQV dy anëtarë të KZAZ-së të spektërve të kundërt politik);

dhe nëse procesi është bllokuar me qëllim zvarritjen e tij, informon urgjentisht KQZ-në, DKZTEZ-në dhe Inspektorin Rajonal, bazuar në informacionin me shkrim të KQV-së dhe/ose dy anëtarë të KZAZ-së të spektërve të kundërt politik me të gjitha mënyrat e komunikimit (telefon/fax).

Paraprakisht KZAZ verifikon emrat e anëtarëve të KQV-së nr..... dhe ia dërgon KQZ-së, së bashku me informacionin/et.

Më pas, KZAZ:
- i shkarkon anëtarët e KQV-së nr.....;
- i zëvendëson ata me anëtarët të tjerë sipas propozimeve të bëra nga subjektet zgjedhore përkatëse;

Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak mungesave të anëtarëve dhe **me kalimin e afatit**, **2 orë**, nuk është kryer zëvendësimi, **KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave** dhe **merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës**.

**Zëvendësimi** i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, **si rregull**, **me persona**, **të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor**.

**Kujdes:** Informacioni drejtuar KZAZ dhe/ose KQZ-së duhet të ketë elementet e përshkruar në shembullin "**ii**". KZAZ lidhur me procedurën e mbledhjes dhe vendimmarrjes vepron si në shembullin "**iii**".

**B.**Nëse KZAZ nuk merr në shqyrtim ankesën ose nuk arrin të zgjidhë situatën e bllokimit të procesit, çdo anëtar i KZAZ-së mund të informojë KQZ-në për zhbllokimin e situatës.

**vi. Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë "anëtarët e GN-it nr.5, KZAZ-së nr.9, qarku Shkodër kanë bllokuar procesin e numërimit meqëllim zvarritjen e procesit"?**



**A.**KZAZ menjëherë:
- merr në shqyrtim ankesën;
- verifikon nëse është bllokuar procesi i numërimit;

dhe nëse procesi është bllokuar me qëllim zvarritjen e procesit, informon urgjentisht KQZ-në, DKZTEZ-në dhe Inspektorin Rajonal me të gjitha mënyrat e komunikimit (telefon/fax).

Paraprakisht KZAZ verifikon emrat e anëtarëve të Grupit të Numërimit nr.5 dhe ia ia dërgon KQZ-së, së bashku me informacionin.

Më pas, KZAZ:
- i shkarkon anëtarët e GN-it nr.5;
- i zëvendëson ata me anëtarët të tjerë sipas propozimeve të bëra nga subjektet zgjedhore përkatëse;

Nëse ndonjë nga subjektet zgjedhore që ka të drejtë të propozojë anëtarë të GN-it nuk paraqet asnjë kandidaturë, Grupi i Numërimit vazhdon numërimin edhe me dy anëtarë.
**Kujdes:** Informacioni drejtuar KQZ-së-së duhet të ketë elementet e përshkruar në shembullin "**ii**". KZAZ lidhur me procedurën e mbledhjes dhe vendimmarrjes vepron si në shembullin "**iii**".
**B.**Nëse KZAZ nuk merr në shqyrtim ankesën ose nuk arrin të zgjidhë situatën e bllokimit të procesit, çdo anëtar i KZAZ-së mund të informojë KQZ-në për zhbllokimin e situatës.

| |
|---|
| **Kujdes** : Në çdo rast, ankesa duhet të ketë elementët e përshkruar në kreun "Ankesa". Vendimet e KZAZ-së ankimohen në KQZ. Dy anëtarë të KZAZ-së kanë të drejtë të bëjnë ankim në KQZ. |

## SHTOJCA 1 – BAZA LIGJORE

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, ligji.nr.8417, datë 21.10.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.01.2007.

**KZ** Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, ligji nr.10019, dt.29.12.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 74 dt. 19.7.2012.

**KP** Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr.7895, dt. 27.01.1995, ndryshuar me ligjet nr.8204, dt. 10.04.1997, nr.8279, dt.15.01.1998, nr.9188, dt.12.02.2004, nr.9275, dt.16.09.2004, nr.9686, dt.26.02.2007.

**Vendimet e KQZ-së:**
**V. nr**.19, dt.06.12.2012 "Strategjia e trajnimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, për zgjedhjet për për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013 ".

**V. nr**. 11, dt.10.01.2013 "Për miratimin e modeleve të shenjave dalluese që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013".

**V. nr**.20, dt.28.01.2013 "Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve, për zgjedhjet për për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013".

**V. nr**.3, dt.07.01.2013 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve".

**V. nr**. 5, dt.08.01.2013 "Për miratimin e modelit të kutisë së votimit, që do të përdoret për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013".

**V. nr**. 6, dt.08.01.2013 "Për miratimin e modelit të kodeve të sigurisë që do të përdoren për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 23.06.2013".

**V. nr**. 8, dt.10.01.2013 "Për miratimin e modeleve të procesverbaleve të administrimit të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013".
**-** Modelet e procesverbaleve të administrimit të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013:

- **PV-KZAZ-02:** Për pajisjen e KZAZ-së nga KQZ me bazë materiale zgjedhore (përfundimtare);
- **PV-KZAZ-03:** Për pajisjen e KZAZ-së nga KQZ (për KQV-të) me materiale zgjedhore;
- **PV-KZAZ-04:** Procesverbal i dorëzimit të fletëve të votimit "Nga KQZ në KZAZ, për çdo QV;
- **PV-KQV-05:** Për pajisjen e KQV-së nga KZAZ me materiale zgjedhore;

- **PV-KZAZ-06:** Për pajisjen e KQV-së nga KZAZ me Vula (kode) të sigurisë, për vulosjen e kutive të votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore;
- **PV-KQV-07:** I vulosjes së kutive të votimit përpara fillimit të votimit;
- **PV-KQV-08:** I mbylljes së votimit;
- **PV-KQV-08-T:** I mbylljes së votimit (Tirana);
- **PV-KZAZ-9:** Për dorëzimin në KZAZ nga KQV-ja të materialeve zgjedhore;
- **PV-GNV-10:** I Grupit të Numërimit të Votave për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore;
- **PV-GNV-10-1**: I Grupit të Numërimit të votave për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara;
- **PV-KZAZ-11:** I dorëzimit nga KZAZ-ja në KQZ të materialeve të inventarizuara;
- **PV-KZAZ-12:** Për dorëzimin ne KQZ nga KZAZ-ja te tabelave të rezultateve, proceverbal konstatimit, vula e KZAZ-së;
- **PV-KZAZ-12-1:** Për dorëzimin ne KQZ nga KZAZ-ja te dokumenteve origjinale qe disponojne KZAZ-te;
- **PV-KZAZ-13:** Për dorezimin ne KQZ nga KZAZ-ja të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore;

**V. nr**. 9, dt.10.01.2013 "Për miratimin e modelit të dhomës së fshehtësisë që do të përdoret për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013"

**V. nr**. 10, dt.10.01.2013,"Për miratimin e modeleve të zarfave të sigurisë, që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013".

**V. nr.**168 , dt.25.02.2013 "Për miratimin e modelit të vulës për KZAZ-të,për KQV-të, Kryetarët e KQV-ve që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013"

**V. nr.**169 , dt.25.02.2013 "Për administrimin dhe shpërndarjen e vulave rezervë për KQV-të, që do të përdoren për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013"

**V. nr.23**, dt.05.02.2013 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletëve të votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013"

**V. nr.**171, dt.27.02.2013 "Për miratimin e modelit të vendimit të KZAZ-ve të Qarkut Fier, për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara nga SEN, për zgjedhjet për Kuvend të datës 23 qershor 2013".

**V. nr.**175, dt.08.03.2013 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletëve të votimit, për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013".

**V. nr.**176, dt.9.03.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 7, datë 23.03.2009"

**V. nr.**179 , dt 25.03.2013 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 10, datë 14.04.2009 "Për procedurat për kriteret e akreditimit të vëshguesve të subjekteve zgjedhore ne KZAZ,KQV,VNV, nga KZAZ- ja për zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë të datës 28.06.2009"

**V. nr.**42, dt.02.12.2010 "Për miratimin e procedurave për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për pjesmarrjen në zgjedhje ditën e votimit".

**Udhëzimet e KQZ-së:**

**U. nr. 1**, dt.12.12.2012 ”Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”.

**U. nr. 1,** dt.15.01.2013 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 1, datë 20.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore”

**U. nr. 3,** dt. **19.02.2013 "**Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së”

**U. nr.4**, dt.19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”

**U. nr**. 01, dt.20.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore”.

**U.nr**.02,dt.25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

**U. nr**. 4, dt. 9.03.2009 ”Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimi

**U. nr**. 5, dt.12.03.2009 "Për administrimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28 qershor 2009”

**U. nr.4**, dt. 9.03.2009 ”Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimit

**U. nr.5**, dt.12.03.2009 "Për administrimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28 qershor 2009”

**U.nr.7**, dt. 23.03.2009 "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në Zgjedhjet për Kuvendin 2009”

**U.nr.12**, dt.21.04.2009 "Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”

**U. nr.18**, dt.03.06.2009 "Për mënyrën e organizimit të punës në VNV, rregullat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja dhe GNV-të, radhën e veprimit dhe ndarjen e detyrave midis anëtarëve të GNV-ve”

**KODI I SJELLJES PËR KOMISIONERËT ZGJEDHORË**

Për t'iu përmbajtur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri dhe profesionalizëm, komisionerët zgjedhorë duhet:

- Të punojnë për t'i ofruar çdo votuesi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar për t'u mundësuar votuesve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.
- Të kryejnë detyrën në mënyrë të pavarur, transparente dhe të paanshme.
- Të punojnë konform ligjeve shqiptare, të zbatojnë Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së dhe t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre, për të siguruar zgjedhje të standarteve ndërkombëtare të lira, të drejta dhe transparente.
- Të marrin vendime të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.
- Të zhvillojnë mbledhje të hapura për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, përfshirë edhe aksesin e lirë në informacionin, mbi bazën e të cilit merren vendimet.
- Të kryejnë të gjitha detyrat e tyre në mënyrë rigorozisht jo-partiake dhe politikisht neutrale.
- Të mos shprehin pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje.
- Të mos mbajnë apo tregojnë simbole apo ngjyra partiake të dukshme.
- Te trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (kandidatët, partitë politike dhe votuesit) në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi.
- Të veprojnë në mënyrë profesionale.
- Të jenë të trajnuar dhe disiplinuar, si dhe të angazhuar të trajtojnë materialet zgjedhore me kujdes dhe respekt.
- Të respektojnë standardet më të larta të etikës në lidhje me komisionerët e tjerë zgjedhorë, kandidatët, vëzhguesit dhe votuesit.
- Të sillen në mënyrë të pagabueshme, të ushtrojnë gjykim të shëndoshë dhe të kenë standardet më të larta të maturisë personale.
- Të mënjanojnë diskutime ose intervista të cilat mund të interpretohen si mbështetje e politikave ose ankimimeve të ndonjë partie politike ose kandidati politik.
- Të trajtojnë përfaqësuesit e mediave me mirësjellje dhe respekt.
- Të mos pranojnë ndonjë dhuratë apo favor nga partitë politike, organizatat apo personat, të cilët mund ose jo të jenë të përfshirë në procesin zgjedhor.
- Të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar që do ketë barazi të mundësive për votuesit, partitë politike dhe kandidatët.
- Të mos marrin pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesi me detyrat e tyre si administrues zgjedhorë.
- Të deklarojnë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.

**Përgatiti :**

**Etleva NUMANI : Pergjegjëse e S. Trajnimit**
**Alfred SPAHIU : Drejtor DKZTEZ**